



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1228/3 Prot.

Tiranë, më 11 . 09 . 2025

V E N D I M

Nr. 214, Datë 11 . 09 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 184, datë 26.08.2025, e bërë nga z. F.K, i përfaqësuar me Prokurën e Posaçme nr. Repertori 1717, nr. Koleksioni 1196, datë 19.08.2025, nga Avokat T.H kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Durrës (DRSHTRR Durrës), me pretendimin për diskriminim, për shkak të “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Ankuesi ka filluar punë në datën 18.01.2017, me detyrën e arkivistit në DRSHTRR Durrës.

Në datë 19.08.2018, ankuesi është ngritur në detyrë dhe ka kryer detyrën e specialist regjistrimi në sektorin e regjistrimit të mjeteve, detyrë të cilën e ka kryer deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës me palën e paditur në datë 20.06.2025. Për këtë marrëdhënie pune me detyrën e re është lidhur kontrata e punës pa afat e firmosur nga palët.

1. Me propozimin për dhënie mase disiplinore, nr. 5848, datë 19.03.2024, DRSHTRR Durrës i ka propozuar Drejtorit të Përgjithshëm dhënien e masës disiplinore vërejtje, duke pretenduar se ankuesi nuk është paraqitur në punë gjatë turnit të dytë në datën 18.03.2024, ora 11:30 dhe nuk ka qenë prezent në vendin e punës në datë 19.03.2024, ora 08.40.

Me propozimin për dhënie mase disiplinore nr. 13854, datë 15.07.2024, DRSHTRR Durrës i ka propozuar Drejtorit të Përgjithshëm dhënien e masës disiplinore vërejtje me motivacion: “Moszbatim të detyrës funksionale, duke mospranuar regjistrimin e mjetit nr. shasio xxxxx, megjithëse dokumentacioni ishte i rregullt, edhe pasi eprori ka konfirmuar vazhdimin e procedurave të regjistrimit”.

Me Urdhrin nr. 1358, datë 23.07.2024, DPSHTRR ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje”, duke argumentuar se: “Moszbatim të detyrës funksionale, duke mos pranuar regjistrimin e mjetit me nr. shasio xxxxx, megjithëse dokumentacioni ishte i rregullt, edhe pasi eprori ka konfirmuar vazhdimin e procedurave të regjistrimit”.

Kundër këtij urdhri, ankuesi ka bërë ankim të Drejtorit të Përgjithshëm në datë 25.07.2024. Për këtë ankim, nuk ka marrë asnjë përgjigje.

2. Nga Drejtori Rajonal me shkresën nr. 22984, datë 09.10.2024, i është propozuar Drejtorit të Përgjithshëm dhënia e masës vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna për ankuesin, duke pretenduar: “1. Gjatë kryerjes së detyrës së tij funksionale shfaq një papërgjegjshmëri ndaj detyrave institucionale 2. Gjatë kryerjes së detyrës së tij funksionale nuk është shumë produktiv dhe nuk shfrytëzon me efikasitet orarin zyrtar të punës..... 3. Gjatë kryerjes së detyrës së tij funksionale, në mënyrë të përsëritur shfaq sjellje jo etike dhe indiferente ndaj urdhrave dhe sugjerimeve të eprorit.....”.

Me Urdhrin nr. 19266/2, datë 20.11.2024, të DPSHTRR është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”.

Kundër këtij urdhri, ankuesi ka bërë ankim te Drejtorit të Përgjithshëm në datë 25.11.2024.

Nga DPSHTRR me shkresën me lëndë: “Njoftim mbi fillimin e bisedimeve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës” nr. 4256/3, datë 10.06.2025, ankuesi është njoftuar se në datë 13.06.2025, do të zhvillohet takimi për zgjidhjen e kontratës së punës.

Nga ankuesi në datë 12.06.2025 është mbajtur qëndrim në lidhje me pretendimet e DPSHTRR.

Takimi është zhvilluar në datë 13.06.2025 dhe është mbajtur procesverbal, sipas të cilit palët kanë qëndruar në argumentet e tyre.

Nga DPSHTRR është nxjerrë Urdhri nr. 701, datë 20.06.2025, “Për zgjidhje të menjëhershme të kontratës së punës” me motivacion: “Moszbatim të detyrës funksionale, në mënyrë të përsëritur, jo me produktivitet dhe duke mos shfrytëzuar me efikasitet orarin zyrtar të punës, si dhe duke mos bashkëpunuar për mbarëvajtjen e punës dhe konkretisht ka rezultuar se numri i veprimeve të kryera prej tij gjatë periudhës janar-shtator 2024 është shumë më i ulët se i specialistëve të tjerë të regjistrimit. Gjithashtu dhe marrë shkas nga fakti se pavarësisht dhënies së masës disiplinore “Vërejtje” me Urdhrin Nr. 1358, datë 23.07.2024, nga ky punonjës nuk ka patur reflektim”.

Rezulton se për vitet 2017-2023, ankuesi është vlerësuar shumë mirë dhe për vitin 2024 mjaftueshëm.

Sipas kontratës së punës, statutit të DPSHTRR dhe rregullores së saj, puna e kryer nga ankuesi dhe të gjithë punonjësit e punëdhënësit nuk është punë me normë, por me kohë. Nuk ka asnjë parashikim ligjor dhe kontraktor se ankuesi dhe kolegët e tij të sektorit të regjistrimit të mjeteve duhet të punojnë jashtë orarit zyrtar çdo ditë dhe punonjësit e tjerë të respektojnë orarin zyrtar 8-16. Neni 3/4, 12/d dhe f, i statutit, parashikon se marrëdhëniet e punës në DPSHTRR rregullohen sipas Kodit të Punës dhe neni 43 i Rregullores parashikon se orët shtesë urdhërohen nga Drejtori i Përgjithshëm dhe duhet të paguhen brenda 2 muajve. Në rastin konkret nuk ka pasur asnjë urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm që përcakton se kur duhet të punojë jashtë orarit sektori i regjistrimit të mjeteve, sa orë do të punojë dhe urdhërimi i pagesës brenda dy muajve. Në rastin konkret ankuesi dhe sektori i tij janë detyruar nga Drejtori Rajonal të punojnë jo një ditë, por në vazhdimësi jashtë orarit zyrtar, pa një urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe pa pagesë. Ky sektor është diskriminuar duke punuar më shumë se sektorët e tjerë, jashtë orarit dhe pa pagesë. Në këtë rast ankuesi dhe sektori ku ai punon është diskriminuar duke u detyruar të punojë tej orarit zyrtar në mënyrë të vazhdueshme dhe me orar shumë të zgjatur. Prej punëdhënësit janë kryer veprime diskriminuese me qëllim që ti bënte ankuesit të pamundur të drejtën për të punuar, duke shkelur neni 9 dhe 146/c të Kodit të Punës.

Ankuesi ka pasur detyrë tjetër shtesë për të kryer, që ka qenë specialist identifikimi dhe njëkohësisht nuk ka qenë për 55 ditë në punë, për shkak të sëmundjes dhe për tre javë ka qenë edhe me leje të zakonshme, rrethana që nuk i janë marrë parasysh në rendimentin në punë kur është krahasuar me kolegët e tjerë. Ai është diskriminuar në raport me kolegët e sektorit të regjistrimit të mjeteve ku rendimenti në punë atij, i është llogaritur edhe për ditët që nuk ka qenë në punë dhe kolegëve mesatarja orare i është marrë duke përfshirë edhe punën e bërë prej tyre jashtë orarit zyrtar.

Ankuesi e ka mirëkuptuar punëdhënësin për të punuar në disa raste jashtë orarit zyrtar, por kjo nuk mund të ndodhte përditë. Po ashtu kjo punë duhet të paguhej dhe jo të kthehej në punë të papaguar.

Në momentin që ankuesi nuk pranoi të punojë pa një urdhër të punëdhënësit ku të pasqyrohej puna jashtë orarit, ai u transferua në Tiranë, në kundërshtim me kontratën e punës dhe në kundërshtim me ligjin. Diskriminimi vazhdoi edhe më tej kur ankuesi u largua nga puna duke u përdorur si argument puna jashtë orarit e kryer nga kolegët e tij. Pra kriteri ishte sjellja e kolegeve dhe jo zbatimi i ligjit prej ankuesit.

Trajtimi i diferencuar ka ndodhur duke dëmtuar gjendjen ekonomike të ankuesit, gjendje e cila parashikohet si situatë e mbrojtur nga neni 1 dhe 12, i ligjit kundër diskriminimit. Ankuesi ka pasur një punë me të cilën krijonte të ardhura për të jetuar dhe krijuar një jetë sociale të kënaqshme. Pra, ankuesit i është dëmtuar gjendja ekonomike nga veprimi i DPRRTSH, duke i zgjidhur kontratën e punës për shkaqe që e kanë diskriminuar ankuesin nga punonjësit e tjerë.

Për shkak të veprimeve të DPRRTSH dhe DRSHTRR Durrës duke i zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontratën e punës së ankuesit, trajtimi i diferencuar ka sjellë si pasojë pamundësinë e ankuesit për të ushtruar të drejtat dhe liritë ekonomike të njohura nga Kushtetuta.

Ankuesi është vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, nga ana e DPSHTRR, për shkak të gjendjes ekonomike, duke e detyruar të punojë jashtë orarit zyrtar, në një situatë normale pune dhe të përhershme të punëdhënësit dhe pa pagesë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe dëmshpërblim prej 21 paga mujore.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Në ankesën e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është pretenduar se trajtimi i tij i padrejtë apo i pafavorshëm nga DPSHTRR dhe DRSHTRR Durrës, ka ardhur për shkak të gjendjes së tij ekonomike.

Së pari, dokumentimi i shkakut për të cilin pretendohet diskriminimi është thelbësor në çështjen e provimit të tij, për të cilin ankuesi pretendon se ka ardhur si pasojë e posedimit të tij.

Së dyti, pasi ankuesi të ketë provuar se mbart shkakun e pretenduar, duhet që të sjellë indicie, fakte apo prova që të dokumentojë, se pikërisht bazuar në këtë shkak (gjendja ekonomike), ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme nga ana e DPSHTRR dhe DRSHTRR Durrës.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon një shkak të mbrojtur, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkakun e pretenduar, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi është gjendja ekonomike e ankuesit.

Pala ankuese nuk ka parashtuar fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të DPSHTRR dhe DRSHTRR Durrës, që të jenë motivuar apo nxitur nga gjendja ekonomike e ankuesit.

Dokumentimi i një karakteristike individuale është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas, të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me një karakteristikë individuale.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përgjashtimit* ose *preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri apo trajtim të pabarabartë, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson, se ankuesi nuk ka dhënë informacion për të shpjeguar dhe dokumentuar gjendjen e tij ekonomike, në kuptim të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”¹.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se: “*Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj².

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 184, datë 26.08.2025, të subjektit ankues F.K, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

¹ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

² Për analogji citojmë vendimet: nr. 314, datë 19.12.2024 dhe nr. 50, datë 06.03.2025, të KMD-së.